



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga një parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-2164/1 datë 14.16.2021, NDËRPRITET
KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.
Lënda me numër 12-2164 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-2164/1 të datës 20.07.2021 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga parashtruesi panjohur. Pretendimet e paraqitura në denoncim kanë të bëjnë me dyshimet për punësim të paligjshëm të personit ///. Sipas pretendimeve, ky person nuk i plotësonte kushtet e punësimit të vendit të punës konkrete, veçanërisht jo për sa i përket llojit dhe shkallës së arsimit, në përputhje me aktet e brendshme të //. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, nuk u dorëzuan prova.

Pas mbikëqyrjes në përmbajtjen e denoncimit, KSHPK-ja kërkoi veprim kompetent nga Inspektorati shtetërorë i punës i RMV-së, i cili në përgjigjen e tijë drejtuar KSHPK-së theksoi se në rastin konkretë realizoi mbikëqyrje të jashtëzakonshme në institucionin e përmendurë, në bazë të së cilës konstatoi se punësimi i personit zyrtarë të theksuarë ishte zbatuar në mënyrë ligjore dhe të drejtë. Personi i plotësonte kushtet e parapara në aktet e brendshme në institucionin e sipër përmendurë, ndërsa procedura e punësimit ishte e drejtë dhe në mënyrë ligjore e zbatuar. Për këto arsye, KSHPK-ja vlerësoi se rasti nuk kishte elemente për veprime të mëtejshme.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Arkivi i KSHPK -së

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: Mr.Sh. S.

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОЌ
ПЌР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Крыетаре,
Biljana Ivanovska

